



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PROKURORIA PRANE GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË PËRMET

NJOFTIM

Nr. 1550 Prot ,datë 09.11.2020

Bazuar në ligjin Nr.97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, urdhërin e Prokurorit të Përgjithshëm “Për strukturën organike të Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Përmet”, me qëllim plotësimin e një vendi vakant në pozicionin “Kryesekretar pranë prokurorëve” ,komisioni i përbërë dhe shqyrtimit të dokumentacionit

Njofton:

1. Fillimin e procedurës për konkurim të hapur të kandidatëve për pozicionin “K/Sekretar pranë Prokurorëve” në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Përmet .
2. Në zbatim të neneve 74-76 të ligjit Nr.97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë “ kandidatët përvec kushteve të përgjithshme për tu pranuar në Shërbimin civil, kërkohet të jenë diplomuar në shkencë ekonomike, në nivelin “Master Shkencor” ose të barasvlefshëm me të, sipas përcaktimeve të legjislativës të arsimit të lartë, dhe të ketë praktikë profesionale ose çdo lloj përvojë profesionale në prokurori të paktën për 1 (një) vit kalendarik ose në administratën shtetërore së paku tre vjet.
3. Kandidatët që kërkojnë të konkurojnë për pozicionin e lirë të punës “Kryesekretar/e” duhet të paraqesin dokumentacionin e mëposhtëm:
 - Kërkesë me shkrim
 - Curiculun Vitae
 - Dokument identifikimi
 - Vërtetim, të gjendjes gjyqësore

- Raport mjeko – ligjor
- Te mos kete mase disiplinore te largimit nga sherbimi civil, qe nuk eshte shuar sipas ligjit per nepunesin civil.
- Te kete eksperience pune mbi tete vjet, minimalisht pese vjet si nepunes zbatues.
- Diplomën universitare te nivelit (3+2) dhe liste notash te noterizuar.
- Cdo dokument tjetër që vërteton praktikat profesionale, formimin profesional, dëshmi kualifikimi ose specializimi që mund të ketë kryer.
- Çertifikate te gjuhes se huaj(nese ka)
- Dëshmi kompjuteri ne programet kompjuterike Ms Office-Word dhe Exel, dëshmi te njohurive ne programet kompjuterike per menaxhimin financiar: Alpha, Financa 5.

4. Kandidatët kanë të drejtë që kërkesën me shkrim së bashku me dokumentacionin ta dorëzojnë jo më vonë se data 20.11.2020, ora 16:00.

KOMISIONI I PRANIMIT DHE SHQYRTIMIT TË DOKUMENTACIONIT